




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Datë: 23.04.2018

Rahovec

-III- Nr. i prot. 358 Më 23.04.2018
Br. prot. Dt. 2018
RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural duke shqyrtuar kërkesën e Shoqatës së Bletarëve nga Rahoveci, Komuna e Rahovecit me Nr.124 të datës, 10.04.2018 dhe duke u bazuar në nenin 62, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 85 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës 01Nr.1005 të datës 29.03.2017, nenit 26 të Rregullores 01Nr.1092 të datë 27.03.2015 për organizimin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësit e administratës të Komunës së Rahovecit dhe nenet: 3, 21, 44 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative Nr.05/ L-031 të datës 05.05.2016, Ligji Nr.02/L-111 për Bletari, Neni 3, 4, 5 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.15/2008 kjo Drejtori merrë këtë:


VENDIM

1. **APROVOHET** Kërkesa e Shoqatës së Bletarëve nga Komuna e Rahovecit me Nr.124 të datës, 10.04.2018 dhe **INDALOHE**t subjekteve të ndryshëm migrimin e bletëve nga Komunitat të tjera në hapësirat e Komunës së Rahovecit pa lejen paraprake të organeve kompetente të Komunës së Rahovecit (Inspektorit të Veterinës).

Arsyetim

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural pas shqyrtimit të kërkesës së Shoqatës së Bletarëve të Komunës së Rahovecit me Nr.124 të datës, 10.04.2018 dhe pas përfundimit të aplikimit për pagesat direktë (Subvencioneve) për bletari dhe e duke u bazuar në numri e aplikuarve për këtë vit si dhe numrit të madh të koshereve të bletëve të deklaruar nga ana e aplikuesëve – bletarëve në Komunën tonë si dhe duke u bazuar në planifikimin nga DBPZHR-Rahovec për respektimin e hapësirave për kullos dhe mbajtjes të distancës të përcaktuar me rregullativën në fuqi, prandaj kjo Drejtori ka vendosur sikurse në dispozitiv.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë që në afate prej 30 ditë të paraqes Ankesë Kryetarit të Komunës së Rahovecit. Ankesa parashtrrohet përmes kësaj Drejtorie e taksuar 1 Euro .


Drejtoria
Berat Duraku